

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ushtria amerikane konfirmon se ka vendosur armë në hapësirë.
ADRESA	https://www.koha.net/bote/shba-ja-e-konfirmon-vendosjen-e-nje-armeve-hapesinore-ne-orbit-en-e-tokes
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 01:58:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 07:33:57 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	50433fb23b08ecbe0b7e8505356424c425bc1f67836eff406c7d22d71e9dc905
TEKSTI	90135af3464226615e6948eda881b7a4b6605855297cf899f15843f9df1a36bc
PAMJA	6dac26a0297bda10c4a54bd8092fbca792868564c46d9da186ac64eff9cf13d9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4f0aaf44972467b291af319fbe53ec7c262a1ea503025cd172b888474f65efa9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b76c045c30cbbea9eae7a42cd456659a809b623ad6b8382f688578771e275bcf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4f0aaf44972467b291af319fbe53ec7c262a1ea503025cd172b888474f65efa9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

BOTË

Ushtria amerikane konfirmon se ka vendosur armë në hapësirë



15 shtator 2026 09:33

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

SHBA-ja ka konfirmuar vendosjen e një arme hapësinore në orbitën e Tokës. Kjo është hera e parë që vendi pranon ekzistencën e kapaciteteve të tilla sulmuese.

Sekretari amerikan i Forcave Ajrore, Troy Meink, ka deklaruar se arma e vendosur në orbitë ishte e domosdoshme për të mbrojtur forcat amerikane nga veprimet armiqësore.

Duke folur të hënën në Konferencën për Ajrin, Hapësirën dhe Kibernetikën, Meink ka thënë se SHBA-ja ishte e përgatitur përballë "kërcënimeve në zhvillim", por nuk ka dhënë detaje të mëtejshme mbi kapacitetet e armës apo kohën kur ajo u vendos në orbitë.


Drejtuues të lartë ushtarakë kanë deklaruar më parë se planifikonin të forconin kapacitetet ushtarake në hapësirë, duke iu referuar programeve ruse dhe kineze që synojnë zhvillimin e mënyrave për të sulmuar dhe neutralizuar satelitët amerikanë në rast konflikti të ardhshëm.

Administrata Trump ka deklaruar se kapacitetet hapësinore si dhe raketat përgjuese, përbëjnë një pjesë thelbësore të sistemit të planifikuar të mbrojtjes "Golden Dome" (Kupola e Artë), që synon të mbrojë SHBA-në nga raketat dhe kërcënimet e tjera ajrore.

Një traktat i vitit 1967 ndalonte vendosjen e armëve të shkatërrimit në masë në orbitë. Që atëherë, fuqitë kryesore, përfshirë SHBA-në, Rusinë dhe Kinën, kanë eksploruar kapacitete të tjera jashtë kornizës së traktatit, siç është shënjestrimi i satelitëve të rivalëve, të cilët janë jetikë për komunikimet ushtarake, mbikëqyrjen dhe navigimin.

Vitin e kaluar, presidenti Donald Trump, ka nxjerrë një urdhër ekzekutiv që theksonte rolin e Forcës Hapësinore të SHBA-së jo vetëm në mbrojtjen e aseteve, por edhe si forcë sulmuese.

Edhe



Botë • 3 sht 2026

Putini përmend mundësinë e një marrëveshjeje paqeje me Ukrainën

Futboll.

Espi e shpëton Realin nga turpi

Arbëri.

Kurti: Shqiptarët e Luginës kanë nevojë për bashkëpunim e përgjegjësi të përbashkët

Arbëri.

Hehir: Turp i madh që një gjykatë e huaj që iu imponua Kosovës t'i shpallë fajtorë figurat e UÇK-së

Futboll.

Zyrtare: Lionel Messi ftohet nga Argjentina

Kulturë.

"Lufta nën akuzë..." demaskon rishkrimin e historisë së çlirimit

Futboll.

Liverpooli eliminon Tottenhamin nga Kupa e Ligës

Forca Hapësinore e SHBA-së, dega më e re e ushtrisë amerikane në më shumë se 70 vjet, është krijuar në vitin 2019 si një masë për të mbrojtur asetet amerikane në hapësirë, përfshirë qindra satelitë që përdoren për komunikim dhe mbikëqyrje.

Në fillim të shkurtit, është zbuluar se dy satelitë rusë me shumë gjasa kanë përgjuar komunikimet e të dhjetëra satelitëve evropianë që nga pushtimi i Ukrainës nga Rusia në vitin 2022.

Përgjime të tilla mund t'u kenë mundësuar shërbimeve të inteligjencës ruse të lexojnë të dhënat e ndjeshme që ata transmetojnë, ose hipotetikisht, madje të marrin kontrollin e satelitëve.

- #SHBA
- #ARMËT
- #KINA
- #RUSIA

Artikuj të ngjashëm



Botë • 15 gus 2026

A mund të pretendojë Moska se ende është superfuqi ushtarake?



Botë • 6 gus 2026

Trumpi mohon se SHBA-ja po përballlet me mungesë armësh



Botë • 21 maj 2026

Irani po rindërtion bazën industriale ushtarake më shpejt se sa pritej, thotë inteligenca amerikane



Botë • 20 maj 2026

Putin dhe Xi kritikojnë “Kupolën e Artë” të Trumpit

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

- Marketing
- Politika e privatësisë
- Kushtet e përdorimit
- Udhëzime për përdorimin e IA-së
- Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

